



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

Nr.	10-320/01-0026587
No.	10-320/01-0026587
Data.	07.07.2025

REPUBLIKA E KOSOVES
KOMUNA E SKENDERAJ
KOMUNAL ASSEMBLY OF MUNICIPALITY SKENDERAJ
SKENDERAJ



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural

DATE/A:	07.07.2025
PËRZA/TO:	Fermerët e Skenderajt
CC:	Z. Fadil Nura, Kryetar i Komunës Skenderaj
NGA/OD/FROM:	Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, z. Behxhet
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Thirrje për aplikim me FAO dhe UN Women



THIRRJE PËR APLIKIM

Komuna e Skenderaj në kuadër të projektit “Promovimi i fuqizimit të grave rurale në Kosovë”, i implementuar nga FAO dhe UN Women, dhe i financuar nga Zyra Austriake për Zhvillim (ADA), shpall thirrjen për aplikim për mbështetje me pajisje bujqësore.

Ky projekt synon të:

- heqë barrierat strukturore dhe të adresojë normat e dëmshme gjinore,
- përmirësojë qasjen në pronësi dhe burime për gratë në sektorin bujqësor dhe sektorët e lidhur me të,
- prezantojë teknologji që kursejnë kohë dhe punë,
- ofrojë mundësi të reja dhe inovative të financimit për gratë rurale.

Kush mund të aplikojë?

Të drejtë aplikimi kanë gratë që kanë marrë pjesë në trajnimet e organizuara nga projekti.

Afati i aplikimit:

Thirrja do të jetë e hapur nga data **7 Korrik 2025** deri më **21 Korrik 2025**, ora 12:00.

Mënyra e aplikimit:

Formularët e aplikimit mund të merren pranë Zyrës së Drejtorisë për Bujqësi në Komunën e Skenderajt.

Sesion informues:

Për të gjitha gratë e interesuara, do të organizohet një sesion informues më **10 Korrik 2025**, duke filluar nga ora **13:00**, në Sallën e Asamblesë Komunale.